



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3539/13 Prot.

Tiranë, më 21.12 2023

V E N D I M

Nr. 82 datë 21.12 2023

**“PËR
PJESËMARRJEN E UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS SI PARTNER NË
KONFERENCËN E 10-TË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE TË KINEZIOLOGJISË,
FAKULTETI I KINEZIOLOGJISË/UNIVERSITETI I ZAGREBIT,KROACI”**

Në zbatim të nenit 3, nenit 49, nenit 38 të ligjit nr.80/2015 ” Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës neni 43, Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për miratimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; në Vendimin e Rektoratit nr. 109 datë 01.11.2023 “Për propozimin e pjesëmarrjes së UST si partner në Konferencën e 10—të Shkencore Ndërkombëtare në Kineziologji të Fakultetit të Kineziologjisë/Universiteti i Zagrebit, Kroaci, në Vendimin e Rektorarit me nr.121 datë 12.12.2023, në Vendimin e Senatit Akademik me nr.120 datë 14.11.2023, në Vendimin e Senatit Akademik me nr.136 datë 19.12.2023, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 21.12.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë pjesëmarrjen e Universitetit të Sporteve të Tiranës si partner në Konferencën e 10-të Shkencore Ndërkombëtare të Kineziologjisë, e cila do të organizohet nga Fakulteti i Kineziologjisë, Universiteti i Zagrebit, Kroaci në datat 12-15 shtator 2024 në Opatija, Kroaci.
2. Të miratojë pagesën e tarifës së pjesëmarrjes në këtë konferencë në shumën 3250 euro e ndarë si më poshtë:
 - pagesa e tarifës prej **250 euro** për pjesëmarrjen e **10 anëtarëve të stafit akademik** të UST që do të dërgojnë punimet e tyre në këtë Konferencë;
 - pagesa e tarifës prej **150 euro** për pjesëmarrjen e **5 studentëve të UST** që do të dërgojnë punimet e tyre në këtë Konferencë;
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Zhvillimit të Programve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

ARTUR COBANI

